

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Albdurazzo-Group-91L&E” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

Z. Almird Pumi, shtetas Shqiptare, i datëlindjes 22/05/1980, lindur në Durrës, banues në Durrës, Lagjja Nr. 1, Rruga Kleosteni, Pallati CoAL, Kati 6, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. leternjoftimi 034200983 dhe nr. personal I00522137J.

Pjesa e përgjithshme

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot me datë 12/03/2023 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “Albdurazzo-Group-91L&E”. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “Albdurazzo-Group-91L&E”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qëndrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Albdurazzo-Group-91L&E”, do të ketëseline e saj qëndrore në Lagjja nr. 1, Rruga Kleosteni, Pallati CoAL, Kati I 6-te, numer pasurie 24/600, zona kadastrale 8512, Durrës.

3.2 Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Agjensi detare dhe spedicionere. Spedicion të mallrave, shërbime spedicionere, detare, tokësore, ekspertizë survejor matje anijesh me ullazh, si dhe survejim për ngarkesat e anijeve, shërbim ormexhimi,

lidhje-zgjidhje anijesh. Shërbime agjensi detare dhe të rekomandimeve detare: broker detar, ajror dhe siguracionesh, shërbime detare dhe ajrore: shërbime të transportit dhe të ngjashme me të, shërbime spedicioni për ngarkesa të vogla dhe me mjete transporti vendase brenda dhe jashtë Shqipërisë; shërbime për aktivitet depozitimi dhe magazinimi i mallrave dhe l mjeteve në magazinat ose depozitat nacionale ose të tjera; përgatitjen e praktikave doganore në përgjithësi për llogari të të tretëve, aktivitetet në veprimet portuale, asistencë dhe oraganizim i operacioneve të ngarkim/shkarkimit të mallrave dhe pasagjerëve; shërbime që lidhen me aktivitet të komisarit të avarive dhe likujdatorit të avarive; organizimi i shkarkimit dhe lëvizjes së kontenierëve dhe veprimtari turistike dhe tour operator. Shërbime portuale, shërbime agjencie spedicionere, shërbime detare, pastrime/marrje mbeturinash portuale. Survejim, kontroll spedicioner. Agjensi doganore, detare, spedicionere në transportin detar, tokesor, automobilistik, transport mallrash dhe udhëtarësh brenda dhe jashtë. Dhënie me qera. Ka të drejtë të bashkëpunojë me qëllim fitimi në ndërmarrje ose shoqëri të tjera të çfarëdo lloji, si dhe sido që të jenë krijuar ato; çdo lloj aktiviteti financiar, tregtar, industrial, ndërtimi që do të shihet në interes të realizimit të objektit social të saj. Shoqëria gjithashtu ka të drejtë të japë hua, financime për të tretët për shoqëri që lidhen me të ose për shoqëritë që kontrollohen nga vet ortakët. Mund të marrë ndihma ose financime nga çfarëdo enti publik ose privat, shqiptar ose të huaj, nga institute bankare ose nga shoqëri që lidhen me të ose që kontrollohen nga ortakët. Furnizim anijesh me materiale të ndryshme konsumi, karburant, lubrifikantë si dhe të gjitha pajisjeve të nevojshme për kryerjen e procesit teknologjik. Transportim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë për import dhe eksport të mallrave të ndryshme industriale. Transportim dhe tregtim me shumicë e pakicë për import – eksport të kimikateve të ndryshme, etj. Shërbime hotelerie dhe turistike të të gjithë llojeve përfshirë organizimin eskursionesh, për udhëtime tokësore, ajrore dhe detare, përgatitje biletash, shërbime dhe rezervime hotelesh brenda dhe jashtë vendit dhe transport turistësh brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, marrje dhe dhënie automjetesh me qera, shërbimi me qëllim promovimi dhe nxitjen e turizmit çdo aktivitet tjetër që lidhet direkt apo indirekt me aktivitetet e lartpërmendura, shkëmbim apo çdo transaksion tregtar në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, shitje dhe blerje, pjesëmarrje në shoqëri, degë, konsorciume ose ente të tjera, garantimi dhe vendosja e barrave (mbi pasuritë e luajtshme dhe paluajtshme), si dhe lidhja e çdo marrëveshjeje financiare. Organizime të panairëve turistike dhe pjesëmarrje në të. Shërbime estetike dhe parukerie, tregti të artikujve të parukerisë me shumicë dhe pakicë, shitje suvenirësh dhe artikuj industrial, këmbim valutor. Projektme dhe menaxhim në dhënie e asistencës teknike për realizimin, ndërtimin, rikonstrukcion, riparime dhe shërbime teknike periodike, të anijeve, trageteve dhe mjeteve të ndryshme të lundrimit detar dhe ujor, të çdo tonazhi, si për vete dhe të tretëve, dhënie e konsulencës dhe kryerje shërbimi për kontrollin dhe përpunimin e anijeve të ankoruara në porte. Menaxhim për blerje, shitje, armim, crowing, kryerjen e shërbimeve teknike ISM dhe ISPA për anije, jahte, tragete dhe të çdo mjeti tjetër lundrues, vendas apo të huaj, marrje dhe dhënie me qera të mjeteve të ndryshme të lundrimit, kryerjen e shërbimeve për përmirësimin e infrastrukturës portuale dhe atë të pastrimit detar, infrastrukturës ujore lumore dhe liqeneve. Shërbime kontabiliteti. Shërbime për përgatitjen e pasqyrave financiare ose raporteve financiare. Shërbime për këshillime në fushën e tatim taksave. Shërbime për këshillime financiare. Shërbime për këshillime në raport me kuotat, aksionet apo tregtimin e tyre. Shërbime në rolin e likuidatorit në personat juridik. Shërbime si ekspert kontabiliteti në proceset gjyqësore. Shërbime vlerësimi pasurish të paluajtshme. Shërbime si ekspert vlerësues pasurish në procese gjyqësore. Shërbime konsulence ligjore dhe asistencë për personat juridik dhe fizik në fushën civile, penale, administrative, bankare, tregtare, rregullat e prokurimeve publike dhe koncensioneve. Konsulencë dhe shërbime në të drejtat e konsumatorit apo të drejtat e sigurimeve shoqërore, shëndetësore apo të punësimit, të drejtat e emrit dhe të autorit. Mbrojtja e të drejtave me pasojë dëmshpërblime në fushën e sigurimeve dhe në të gjitha format e dëmshpërblimit si rrjedhojë e dëmit të shkaktuar. Konsulencë dhe informacion biznesi, konsulencë për shoqëritë tregtare dhe OJF-të, konsulencë në fushën e liçensimit për të gjitha kategoritë e ushtrimit të lirë të profesionit. Konsulencë e plotë në procedurat ligjore të regjistrimit për kompani shqiptare dhe të huaja. Përfaqësim ligjor dhe asistencë gjatë procedurave gjyqësore dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtari tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura

të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "Albdurazzo-Group-91L&E" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë "Albdurazzo-Group-91L&E" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Albdurazzo-Group-91L&E" SHPK është 100.000 (njqindmije) Leke, e ndarë në 1 kuotë, i cili është nënshkruar nga ortaku i vetëm.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Z. Almird Pumi është ortaku i vetëm i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, të barabartë me 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e shoqërisë

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë është Z. Almird Pumi.

NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Almird Pumi

DURRES 12/03/2023

